



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Kodi i lëndës: INF 240
Lënda: Bazat e Obstetrikës për Infermierinë

SYLLABYSI I LËNDËS								
Bazat e Obstetrikës për Infermierinë								
Titullari i lëndës:	Rezarta Lalo <i>Dr në Shkencaat Infermiere</i> _____							
Ngarkesa:	ECTS	Orë mësimi në auditor					Studim individual	Totali
		Leksion	Seminar	Lab	Praktikë	Projekt klinik		
	8	45	0	0	30	0	75	150
Tipologjia e lëndës	Disiplinë nderdisiplinore /integruese të programit							
Vitiakademik /Semestri kur zhvillohet lënda	Viti II, Semestri I							
Lloji i lëndës	Me zgjedhje							
Programi i studimit	Bachelor në "Infermieri të Përgjithshme"							
Kodi i lëndës	INF 240							
Adresa elektronik e titullarit / pedagogut të lëndës	rezarta.petani@univlora.edu.al							

PËRMBLEDHJE DHE REZULTATET E TË NXËNIT	
Përshkrimi i lëndës	Eshte nje lende qe merret me studimin e fenomeneve dhe manifestimeve klinike ne organet e riprodhimit tek gruaja ne kushte normale apo patologjike dhe ka si synim pergatitjen e infermiereve-mami te afta per realizimin e teknikave obsterikale gjate procesit te lindjes, shtatzenise dhe trajtimit te patologjive te saj dhe semundjeve gjinekologjike.
Objektivat e lëndës	<ul style="list-style-type: none">Njohja me fiziologjine, endokrinologjine dhe planifikimin e shtatzenise.Vleresimi i aktivitetit dhe lindjes normale, detyrat dhe metodat e aplikuara.Njohja me komplikacionet e shtatzenise, aktivitetit te lindjes dhe lindjes si dhe strategjitë e menaxhimit të tyre.Njohja dhe strategjite e menaxhimit te semundjeve me te shpeshta gjinekologjike.
Rezultatet e pritshme	Në përfundim të kursit studentët do të jenë në gjendje: <ul style="list-style-type: none">Të realizojnë përkujdesjet infermiere gjate shtatzenise.Të njohin teknikat profesionale në realizimin me sukses te nje lindje normale dhe nderlikimet e mundshme.Te menaxhojne teknikat profesionale ne realizimin e lindjeve distocike.Të njohin komplikacionet mjekesore te shtatzenise, perreth lindjes dhe postpartum si edhe nderhyrjet efikase ne cdo rast.Të njohin rëndësinë e parandalimit të infeksioneve seksualisht te transmetueshme, kancerit cervical, infeksioneve te tjera gjinekologjike dhe trajtimin e tyre.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

KONCEPTET THEMELORE

- Obstetrika është pjesë e shkencës së mjekësisë, që studion fekundimin, shtatzëninë, lindjen, lehoninë në kondita fiziologjike ose patologjike. Ajo ka si objekt kushtet dhe mjetet e asistencës në lindje. Qëllimi i obstetrikes është që shtatzënia të perfundojë në kushte të mira për shëndetin e nënës dhe fëmijës. Kujdesi prenatal ka objektiv të tij lindjen e një fëmije të shëndetshëm si dhe mbajtjen dhe ruajtjen e shëndetit të nënës.
- Termi "obstetrike" vjen nga latinishtja "obstetrix"-mami dhe "obstare" të jesh i pranishëm. Në lashtësi lindja asistohet nga dy mami, ku njëra qëndronte para gruas dhe priste lindjen e fëmijës dhe quhej obstetrix, kurse tjetra qëndronte pas duke mbajtur gruan në lindje nga shpatullat dhe quhej adstetrix.

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
I.	Tema 1 Ç'është OBS. Çfarë studion, objekti dhe qëllimi i saj. Njohja me programin <i>Studenti njihet me syllabusin e lëndës dhe mënyrën e vlerësimit. Gjithashtu ai njihet me konceptin e termi obstetrike dhe qëllimin e kujdesit prenatal dhe periudhës së pas lindjes, lehoninë.</i>	⁽¹⁾ fq.9	Leksion 1 orë
	Tema 2 – Anatomia e aparatit genital femëror <i>Njohja me anatominë e aparatit genital femëror, organet gjendërore të jashtme dhe të brendshme.</i>	⁽¹⁾ fq.10-16	Leksion 1 orë
	Tema 3 – Cikli genital. <i>Njohja me konceptin e ciklit menstrual si edhe ndryshimeve ciklike fiziologjike që ndodhin në ovar dhe miter në ndikimin e hormoneve gonadotrope të hipofizës.</i> Praktikë mësimore: Njohja me repartet dhe shërbimet e OBS në Maternitetin e Spitalit.	⁽¹⁾ fq.19-24	Leksion 1 orë Praktikë 2 orë
II.	Tema 4 – Placenta, struktura, fiziologjia e saj. <i>Njohja me strukturën, zhvillimin dhe funksionet e placentës, strukturave umbilikale dhe likidit amniotik</i>	⁽¹⁾ fq.25-29	Leksion 1 orë
	Tema 5 - Ndryshimet fiziologjike amtare në shtatzëni. <i>Njohja me ndryshimet anatomike, fiziologjike dhe biokimike të organizmit të gruas gjatë shtatzënisë të cilat fillojnë pas fertilizimit dhe vazhdojnë gjatë shtatzënisë dhe që shpesh ndodhin në përgjigje të stimulimit fiziologjike fetale..</i>	⁽¹⁾ fq.30-40	Leksion 1 orë
	Tema 6 - Endokrinologjia e shtatzënisë. <i>Njohja me hormonet më të rëndësishme gjatë shtatzënisë, karakteristikat dhe funksionet e tyre në shtatzëni.</i> Praktikë mësimore në konsultorin prenatal	⁽¹⁾ fq.43-49	Leksion 1 orë Praktikë 2 orë
III.	Tema 7 - Shtatzënia, përkufizime, diagnoza. <i>Diagnoza e hershme e shtatzënisë konsiderohet si një tregues i rëndësishëm për shëndetin publik, që tregon drejtpërdrejt efikasitetin e kujdesit prenatal të ofruar nga sistemet shëndetësore. Studenti njihet me përkufizimet baze në lidhje me shtatzëninë si edhe simptomat kryesore që klasifikojnë në vetvete diagnozën e shtatzënisë.</i>	⁽¹⁾ fq.53-59	Leksion 1 orë
	Tema 8 – Kontrolli prenatal. Anamneza dhe ekzaminimi në OBS. <i>Kujdesi para lindjes është një plan sistematik i kujdesit parandalues, terapeutik dhe edukues që realizohet nëpërmjet vizitave prenatale që gruaje shtatzëne duhet të kryejë pranë shërbimeve shëndetësore të</i>	⁽¹⁾ fq.60-72	Leksion 1 orë



REPUBLICA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	<p><i>kujdesit para lindjes. Studenti njihet me menyren e marrjes se anamnezës, realizimit të ekzaminimit fizik dhe laboratorik si edhe zbulimin e hershem të shtatzënive me rrezik të lartë.</i></p> <p>Tema 9 – Pelvisi femëror, kanali kockor, ekzaminimi i pelvisit. Njohja me ndertimin anatomik dhe ekzaminimin e pelvisit femëror si një faktor që ndikon në fiziologjinë e lindjes.</p> <p>Praktikë mësimore në konsultorin prenatal</p>	(¹)fq.75-79	Leksion 1 orë Praktikë 2 orë
IV.	<p>Tema 10 – Fetusi, dimensionet e tij shenjat e pjekurisë fetale . Studenti njihet me ndryshimet muaj pas muaji të rritjes dhe zhvillimit intrauterin të fetusit, shenjat e pjekurisë së tij si edhe dimensionet fetale. Fetusi dhe dimensionet e tij janë një tjetër faktor që ndikon në fiziologjinë e lindjes.</p> <p>Tema 11–Shkaqet e shpërthimit të aktivitetit të lindjes, shenjat paralajmëruese. Forcat ekspulsonjëse të lindjes. Konsiderata të përgjithshme, perkufizime dhe shkaqet e shpërthimit të lindjes. Studenti njihet gjithashtu me komponentin e trete që ndikon në fiziologjinë e lindjes dhe që janë forcat ekspulsonjëse të lindjes: kontraksionet uterine dhe shterzimety, karakteristikat dhe klasifikimi i tyre.</p> <p>Tema 12 – Aktiviteti i lindjes dhe periudhat e tij. Periudha e dilatacionit. Monitorimi i periudhës së parë të lindjes që përfshin observacionet rutine, ekzaminimin abdominal dhe vaginal..</p> <p>Praktike mesimore në Maternitetin e Spitalit Rajonal</p>	(¹)fq.80-83 (¹)fq.86-91 (¹)fq.92-99	Leksion 1 orë Leksion 1 orë Leksion 1 orë Praktikë 2 orë
V.	<p>Tema 13 – Aktiviteti i lindjes dhe periudhat e tij. Periudha e ekspulsionit <i>Karakteristikat e periudhës së dytë të lindjes dhe menyra e vleresimit dhe kujdesit të gruas gjatë kësaj periudhe.</i></p> <p>Tema 14 – Lindja normale. Mekanizmi i lindjes në prezentacionin oxipital aspekt i përparëm. <i>Procesi i adaptimit të pjesëve të pershtatshme të kokës fetale me segmentet e ndryshme të pelvisit caktojnë mekanizmin e lindjes dhe elementet kryesore të tij, studimi i të cilave është i rëndësishëm të njihet nga studenti-mami.</i></p> <p>Tema 15 –Induktimi i aktivitetit të lindjes. <i>Studenti njihet me konceptin e induktimit dhe stimulimit të aktivitetit të lindjes, indikacionet dhe monitorimin e gruas gjatë administrimit të oksitocines.</i></p> <p>Praktike mesimore në Maternitetin e Spitalit Rajonal</p>	(¹)fq.99-101 (¹)fq.105-108 (¹)fq.109-123	Leksion 1 orë Leksion 1 orë Leksion 1 orë Praktikë 2 orë
VI.	<p>Tema 16 – Vuajtja fetale asfiktike dhe vlerësimi i mirëqenies fetale. Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të vuajtjes fetale asfiktike.</p> <p>Tema 17 – Periudha placentare. Shkolitja normale dhe artificiale e placentës. <i>Njohja me fiziologjinë e fazës së trete të lindjes, periudhën placentare. Studenti njihet me metodat e shkolitjes normale dhe artificiale të placentës.</i></p> <p>Tema 18 – Lehonja normale. Puerperiumi normal dhe patolgjik. <i>Pershkruhen ndryshimet fiziologjike që ndodhin në periudhën e</i></p>	(¹)fq.124-126 (¹)fq.127-133 (¹)fq.134-139	Leksion 1 orë Leksion 1 orë Leksion 1 orë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	<p><i>puerperiumit ose lehonise normale. Gjithashtu trajtohen infeksionet dhe patologjite me te shpeshta infektive gjate lehonise, diagnostikimi dhe trajtimi i tyre..</i></p> <p>Praktikë mësimore në Maternitetin e Spitalit Rajonal.</p>		<i>Praktikë 2 orë</i>
VII.	<p>Tema 19 - Dëmtimet traumatike të gruas gjatë lindjes. Laçeracionet. Epiziotomia. <i>Pershkruhen demtimet traumatike te lindjes qe perfshijne laceracionet cervikale, vaginale, perineale dhe vulvare, klinika dhe riparimi i tyre. Studenti njihet gjithashtu me tekniken e epiziotomise dhe epiziorafise te cilat kane per qellim zmadhimin e hyrjes se vagines, per te lehtesuar lindjen dhe per te parandaluar laceracionet spontane.</i></p> <p>Tema 20 - Sectioesarea. <i>Sectioesarea percakton lindjen e fetusit, placentes, membranave nepermjet nje incizioni ne muret abdominale dhe uterine. Studenti njihet me indikacionet dhe komplikacionet me te mundshme te lindjes se fetusit me operacion cesarian.</i></p> <p>Tema 21 - Lindja premature. <i>Faktoret riskante, diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të lindjes para kohe</i></p> <p>Praktikë mësimore në Maternitetin e Spitalit Rajonal.</p>	<p>⁽¹⁾<i>fq.173-177</i></p> <p>⁽¹⁾<i>fq.182-184</i></p> <p>⁽¹⁾<i>fq.178-181</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p><i>Praktikë 2 orë</i></p>
	<p>Tema 22 – Gravidanca serotine . <i>Etiologjia, diagnostikimi klinik dhe menaxhimi i shtatzenise se vonuar, serotine.</i></p> <p>Tema 23 – Shtatzënia multiple. <i>Studimi i diagnozes, aktivitetit te lindjes dhe nderlikimet e mundshme ametare dhe fetoneonatale te shtatzenise multiple</i></p> <p>Tema 24 – Abortet. <i>Njohja me abortin sipas klasifikimit te tij, shkaqet dhe klinika si edhe metodat e nderprerjes se shtatzenise. Studenti njihet gjithashtu me edukimin shendetesor dhe menyren e trajtimit per secilin tip te abortit.</i></p> <p>Praktikë mësimore në Maternitetin e Spitalit Rajonal</p>	<p>⁽¹⁾<i>fq.178-181</i></p> <p>⁽¹⁾<i>fq.192-194</i></p> <p>⁽¹⁾<i>fq.205-214</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p><i>Praktikë 2 orë</i></p>
	<p>Tema 25 – Mola Hydatidiforme (Mola vesiculosa). <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të moles hydatiforme ose patologjise se vezes humane.</i></p> <p>Tema 26 – Gravidanca ektopike (extrauterine). <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të shtatzenise jashte mitre. Njohja me ekzaminimet speciale dhe masat parandaluese.</i></p> <p>Tema 27 – Placenta previa. <i>Klasifikimi, etiologjia, diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të placenta previa si patologji qe studiohet ne kapitullin e hemorragjive te tremujorit te trete te shtatzenise</i></p> <p>Praktikë mësimore në Maternitetin e Spitalit Rajonal.</p>	<p>⁽¹⁾<i>fq.215-218</i></p> <p>⁽¹⁾<i>fq.219-223</i></p> <p>⁽¹⁾<i>fq.229-232</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p><i>Praktikë 2 orë</i></p>
	<p>Tema 28 – Distaco placentë. <i>Format klinike, mjekimi dhe komplikacionet e shkolitjes para kohe te placentes se inseruar normalisht.</i></p> <p>Tema 29 – Ruptura uterine.</p>	<p>⁽¹⁾<i>fq.224-228</i></p> <p>⁽¹⁾<i>fq.233-236</i></p>	<p>Leksion 1 orë</p>



REPUBLICA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	<p><i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të ruptures uterine. Studenti njihet gjithashtu me masat e parandalimit të kësaj katastrofe obstetrikale e konsideruar e tillë për shkak të shpeshtësisë së vdekjeve ametare..</i></p> <p>Tema 30 – Hemorragjia postpartum. Shoku hemorragjik. Shkaqet dhe trajtimi i secilit prej tyre i hemorragjisë pas lindjes. Njohja me shenjat e hershme dhe të vonshme të shokut hemorragjik dhe masat për parandalimin e tij.</p> <p>Praktikë mësimore në Maternitetin e Spitalit Rajonal.</p>	(¹)fq.237-252	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p><i>Praktikë 2 orë</i></p>
XI.	<p>Tema 31–Sëmundjet e shtatzënisë : Toksikozat e hershme të shtatzënisë.</p> <p><i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të hyperemesis gravidarum ose të vjellat e shtatzënisë.</i></p> <p>Tema 32 – Anemitë e shtatzënisë. Njohja me rrregullimet me të shpeshta hematologjike gjatë shtatzënisë si anemia nga mungesa e hekurit dhe acidit folik, klinika, masat parandaluese dhe trajtimi i tyre..</p> <p>Tema 33 – Sëmundja hipertensive e shtatzënisë . <i>Hypertensioni i nxitur nga shtatzënia përfshin hipertensioni arterial, preeklampsinë dhe eklampsinë, aspektet klinike, menyrën e lindjes dhe trajtimin të secilit prej tyre.</i></p> <p>Praktike mesimore në konsultorin prenatal .</p>	(¹)fq.255-257 (¹)fq.261-265 (¹)fq.389-395	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p><i>Praktikë 2 orë</i></p>
XII.	<p>Tema 34 – Infeksionet e traktit urinar gjatë shtatzënisë. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të infeksionit urinar gjatë shtatzënisë.</i></p> <p>Tema 35 – Patologjitë e likidit amniotik. <i>Diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të patologjive të likidit amniotik: polyhidramnion dhe oligoamnion.</i></p> <p>Tema 36 – Venat varikoza dhe hemorroidet në shtatzëni. <i>Varikozitetet janë kryesisht problem i grave multipare, të cilat shfaqen në kembe, vulvë dhe vaginë duke shkaktuar komplikacione të rënda. Faktorët riskantë dhe menyrat e trajtimit përbejnë çështjet kryesore të trajtuara në këto leksione. Me të njëjten mekanizëm si varicet, zmadhimi i uterusit rrit konxhestionin sekondar venoz të venës porta që komplikohet me hemorroidet.</i></p> <p>Praktikë mësimore në konsultorin prenatal.</p>	(¹)fq.258-260 (¹)fq.271-273 (¹)fq.274-275	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p><i>Praktikë 2 orë</i></p>
XIII.	<p>Tema 37 – Amenorrhea. <i>Klasifikimi,diagnostikimi klinik dhe plani i trajtimit të mungesës patologjike të menstruacioneve, amenorrhese.</i></p> <p>Tema 38 - Hemorragjitë uterine nga shkaqe organike. <i>Shkaqet, diagnostikimi klinik dhe menaxhimi i HUD (hemorragjive uterine disfunktionale).</i></p> <p>Tema 39 – Kanceri cervikal. <i>Kanceri cervikal konsiderohet si neoplazia malinje që mund të parandalohet dhe kurohet dhe sherohet nëse zbulohet në fazat e hershme të tij. Diagnostikimi klinik, masat parandaluese dhe plani i trajtimit janë çështjet kryesore të trajtuara në këto leksione.</i></p>	(¹)fq.288-293 (¹)fq.294-301 (¹)fq.331-335	<p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p> <p>Leksion 1 orë</p>



REPUBLICA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Java	TEMAT E LËNDËS	Literatura referuese	Forma e mësimdhënies
	Praktikë mësimore në Maternitetin e Spitalit Rajonal		<i>Praktikë 2 orë</i>
XIV.	Tema 40 – Endometrioza <i>Pershkruhen teorite e patogjenezes se endometriozes, ekzaminimet diagnostikuese dhe menyra e trajtimit.</i>	⁽¹⁾ fq.339-342	Leksion 1 orë
	Tema 41 – Infertilitetit mashkullor dhe femëror <i>Njohja me fiziologjine e konceptionit, faktoret qe ndikojne ne infertilitetin mashkullor dhe femëror si edhe mjekimi bazuar ne korrigjimin e secilit faktor etiologjik.</i>	⁽¹⁾ fq.343-348	Leksion 1 orë
	Tema 42 – Prolapsi i uterusit. <i>Kjo patologji qe eshte rezultat i difekteve te strukturave mbajtese pelvike te organeve genitale takohet me shpesh ne moshën mbi 50 vjec, pra ne menopauzen e grave. Studenti njihet me kliniken dhe menyren e trajtimit rreshqitjes se uterusit ne ose jashte vagines</i>	⁽¹⁾ fq.336-338	Leksion 1 orë
	Praktikë mësimore në Maternitetin e Spitalit Rajonal		<i>Praktikë 2 orë</i>
XV.	Tema 43 - Sëmundja inflamatore pelvike. <i>Studenti njihet me termin semundje inflamatore pelvike qe eshte infeksioni qe prek endometrium, tubat uterine,ovaret, murin uterin dhe pjesen e peritoneumit parietal. Pershkruhet fiz-patologjia e infeksionit, pasojat e tij ne organet genitale te siperme, teknikat diagnostikuese dhe menyra e mjekimit.</i>	⁽¹⁾ fq.315-322	Leksion 1 orë
	Tema 44 – Vulvovaginitet <i>Njohja me infeksionin qe prek vulven dhe vaginen, faktoret riskante qe rrisin shpeshesine e tyre, komplikacionet e mundshme dhe menyra e trajtimit.</i>	⁽¹⁾ fq.323-330	Leksion 1 orë
	Tema 45 – Menopauza. <i>Fiziologjia e peri dhe menopauzes, simptomat klinike dhe problemet shendetesore qe gjenerojne ne kete periudhe te jetes se gruas. Studenti njihet gjithashtu me trajtimin dhe masat parandaluese te simptomave dhe gjendjeve patologjike te menopauzes.</i>	⁽¹⁾ fq.356-363	Leksion 1 orë
	Praktikë mësimore në Maternitetin e Spitalit Rajonal		<i>Praktikë 2 orë</i>

FORMA E KONTROLLIT TË DIJEVE

FREKUENTIMI:	<p>Kyçi i një edukimi të suksesshem është pjesëmarrja dhe përgatitja. Kërkohej një pjesëmarrje aktive në klasë. Orët e leksionit janë të detyrueshme në masën 75%. Orët e praktikës janë të detyrueshme 100%, në rast të mungesave të justifikuara ora do të zëvendësohet në marrveshje me pedagogun. Të gjithë studentët duhet të paraqiten në orët e praktikës në orarin e përcaktuar dhe të pajisur me përparëse të bardhë dhe flokë të mbledhur (duke respektuar kodin etik të veshjes së infermierit).</p> <p>Lejohen të shlyhen mungesat deri në masën 25% të orëve, nëse ato janë të justifikuara. Në të kundërt studentit humbet të drejtën e futjes në provim. Mungesat janë përgjegjësi personale e studentit, ashtu sikurse edhe detyrat apo testimet e humbura.</p>					
KONTROLLI I VAZHDUESHËM	<i>Forma e vlerësimit</i>	<i>Koha e vlerësimit</i>	<i>Temat mësimore që do vlerësohen</i>	<i>Pikët maksimale</i>	<i>Forma e testimit të njohurive</i>	<i>Përmbajtja e testimit</i>
	Provimi I	Java 7/8	Kapitulli I - V	30 pikë	Provim me shkrim	pyetje me shtjellim dhe pyetje quiz
	Provimi final	Fundi i semestrit	Kapitulli VI-XI	60 pikë	Provim me shkrim	pyetje me shtjellim dhe pyetje quiz



REPUBLICA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

	Vlerësim i vazhduar* (Detyra e kursit*)	Java 14/15	Rastet klinike	10 pikë	Prezantim me gojë	Raportim rasti / Demonstrim procedure
<p>*Detyra e kursit - Do të jetë në formën e një projekti që do të nisë në fillim të semestrit. Studentët do të përshkruajnë rastet më të shpeshta të komplikacioneve të mundshme të shtatzënise, aktivitetit të lindjes dhe lindjes, që hasin në praktikë, duke i krahasuar me përshkrimet teorike të tyre. Gjithashtu do të demonstrojnë procedurën e lirimimit të fetusit në lindjen normale tek manikina dhe do të përshkruajnë cdo rast lindje që kanë asistuar në praktike, bazuar në një format të gatshëm. Do të përshkruajnë asistencën shëndetsore të ofruar në repartin e abortarit dhe lehonise duke i krahasuar me përshkrimet teorike të tyre.</p>						
Konvertimi i pikëve në notën përfundimtare është si më poshtë:						
	40- 49 pikë	50-59 pikë	60-69 pikë	70-79 pikë	80-89 pikë	90-100 pikë
	5	6	7	8	9	10

LITERATURA	
I. Literatura bazë e detyruar	⁽¹⁾ Bazat e OBS për infermierinë R.Lalo, 2013 (Fakulteti i Shëndetit Publik - UV) ISBN: 978-9928-153-61-6.
II. Literatura e rekomanduar	<ul style="list-style-type: none"> ○ Bazat e OBS' O.Gliozheni;R.Moisiu;A.Bimbashi 2002 (F. Mjekësisë – UT). ○ 'Gjinekologjia' A.Manaj 2005 (Fakulteti i Mjekësisë – UT). ○ 'Sëmundjet gjinekologjike' Dr. E.Gjata 2009 (Fakulteti i Infermierisë – UT). ○ 'La disciplina ostetrica'. M.Guana 2006. ○ Obstetrique pour le praticien J.Lansac et al. 2003. ○ 'Obstetric and Gynecology'. William W.Beck,Jr 2005.

VËREJTJE PËRFUNDIMTARE NGA PEDAGOGU I LËNDËS	
Dispozita:	Nga studentët pritet që të zhvillojnë vlera dhe një etike që tregojnë interesat dhe sjelljen e tyre në këndvështrimin profesional. Këto pritshmëri lidhen me paraqitjen në ambientet e Universitetit, përgjegjshmërinë gjatë procesit të mësimdhënies, por jo vetëm, në ndershmërinë e tyre dhe në çështje të drejtësisë sociale. Studentët duhet të respektojnë diferencat individuale, të jenë bashkëpunues, të vlerësojnë aftësitë dhe cilësitë e vetes e të tjerëve, të vlerësojnë format e ndryshme të shprehjes së mendimit dhe zgjedhjeve të secilit. Në përputhje me rregullat etike, studentët duhet të respektojnë diferencat etnike dhe të ndihmojnë me qëndrime integruese e mbështetëse personat me aftësi të kufizuara.
Vonesat	Vonesat në leksione dhe seminare nuk do të tolerohen. Pas hyrjes së pedagogut në auditor nuk lejohet të hyjë asnjë student.
Sjellja profesionale e studentit	Studentët konsiderohen tashmë të rritur dhe kjo kërkon prej tyre një përgjegjësi dhe vetëdërgjegjësim në një nivel më të lartë në lidhje me sjelljen e tyre, qëllimet e interesat për të cilat ata kanë zgjedhur të frekuentojnë universitetin. Duke patur parasysh që kudo infrastruktura universitare dhe ekologjia e mjedisit ku jepen dijet nuk është e përsosur, duhet të vendosim disa rregulla të detyrueshme për të gjithë. Kjo d.m.th., vëmendje gjatë procesit mëimor, celularë të fikur, jo SMS, jo përdorim të mjeteve të tjera digitale me destinacion argëtimin (MP3.etj), jo lojra, jo kuti tualeti nëpër tavolinat e mësimimit, veshje të përshtatshme për të respektuar orën e mësimimit, fjalor (vulgariteti ndalohet rreptësisht) dhe komunikim të pranueshëm brenda dhe jashtë klasës. Për çdo devijance nga këto rregulla, do të ketë penalitete, që përcaktohen në Rregulloren e Universitetit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI VLORË"
FAKULTETI I SHËNDETIT PUBLIK
DEPARTAMENTI I INFERMIERISË

Integriteti akademik dhe e drejta e autorit

Çdo test apo pune me shkrim duhet të jetë tërësisht individuale dhe origjinale. Kjo nënkupton që studentët të krijojnë vetë mbi bazën e koncepteve të argumentuara në leksion abstraksione apo analiza origjinale dhe në pamundësi, të identifikojnë gjithnjë burimin e informacionit të marrë. Nuk do të lejohen plagjiaturat (përzjerjet mikse), apo vjedhjet e informacioneve në rrugë të ndryshme.